



## VENDIMET E MBLEDHJES ME BORDIN E FTK-SË TË DATËS 02 SHKURT 2023

### Vendimi Nr. 2023-01

Bordi mori vendim:

1. Bordi i Ftk-së morri vendim që turnirët e Ftk-së të ulën për 30%, d.m.th të zvogëlohet numri i turnirëve vendor për 30% nga viti i kaluar.

### Vendimi Nr. 2023-02

Bordi mori vendim:

2. Pas diskutimit, Bordi i Ftk-së morën vendim që vajzat që vijnë nga jashtë Kosovës bashkë me trajnerin e tyre të paguhet 100 euro në ditë, për çdo ditë shtesë që ato do të angazhohen për pjesëmarrje në BJKC 2023.

### Vendimi Nr. 2023-03

Bordi mori vendim:

3. Duke u bazuar në rezultatet më të mira që ka treguar Salidin Rama në turne ndërkombëtar, në krahasim me Learta Muharremin, Bordi vendosi ta zgjedh Salidin Ramën të marr pjesë në Mouratoglou Academy në trajnimin njëjavor dhe zgjodhën afatin kohor Tetor – Dhjetor për të marr pjesë në këtë trajnim.

### Vendimi Nr. 2023-04

Bordi mori vendim:

4. Bordi vendosën që Meldin Mustafi të jetë marr pjesë si trajner për U14 dhe Benita Selmanaj si trajnere femër në 14U Development Championship 12U Training Camp, që do të mbahet në Antalya, Turqi. Po ashtu në ditët në vijim do të merret vendim a do të shkoj për trajner për meshkuj për U12: Arian Ibrahimimi apo Edon Ademi.

### Vendimi Nr. 2023-05

Bordi mori vendim:

5. Po ashtu në këtë takim me Bordin u mor vendimi që pagesa e anëtarësisë së Klubit ndaj Federatës bëhet më së voni deri pas përfundimit të turnirit të parë të organizuar nga ai klub, në të kundërtën turneu i radhës nga ai klub nuk do të organizohet.

Data: 02.02.2023